

VENDIM
Nr. 377, datë 26.4.2017

PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM FAMILJARËVE NË NGARKIM TË TË NDJERIT
ANDREA STEFANI

Në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie, përjashtimisht nga kriteret e vendimit nr.429, datë 12.2.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të një pensioni të posaçëm familjar për personat në ngarkim të të ndjerit Andrea Stefani.

2. Pensioni i posaçëm familjar ose shtesa e pensionit familjar të jetë deri në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Përfitues të pensionit ose shtesës së pensionit janë personat e përcaktuar sipas kushteve që parashikon neni 40, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shuma, kur kërkohet nga familjarët, jepet e ndarë në mënyrë të barabartë për çdo përfitues.

3. Efekti financiar, prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh, për vitin 2017 dhe për vitet në vazhdim, të përballohet nga buxheti i sigurimeve shoqërore.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi